

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25), dhe në lidhje me nenin 50, paragrafi (3) nga Ligji i njëjtë dhe nenet 16 dhe 17 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve (Tekst i pastruar) nr.ark.01-4898/1 të datës 22.11.2024, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) nr.ark.01-4241/1 të datës 01.10.2025, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore nr.ark.10-3152/1 të datës 19.08.2026 dhe Konkluzionin nr.ark.02-3374/3 të datës 15.9.2026, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën 31. të mbajtur më 15.09.2026, miratoi si vijon:

Aktvendim për ndërmarrjen e masës – paralajmërim publik

1. PUBLIKISHT PARALAJMËRON Ndërmarrjen publike radiodifuzive (NPR) RADIOTELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonisë – Shërbimi i parë programor (RTM1), për shkeljen e kryer të nenit 50, paragrafi (3) nga Ligji i Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LShMAAV) dhe nenet 16 dhe 17 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve (RrMPM), për mënyrën që në shërbimin programor televiziv të transmetuesit, në filmin artistik „Razuzdaniot dedo (Dirty grandpa)“, të transmetuar më 14 gusht 2026, është kategorizuar gabimisht, dhe shënuar si program i kategorisë së tretë (12+) transmetuar në periudhë të papërshtatshme kohore gjatë ditë-natës.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike, është specifikura në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore nr.ark.10-3152/1 të datës 19.08.2026, si pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojca nr.1.

2. URDHËROHET që Ndërmarrja publike radiodifuzive (NPR) RADIOTELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonisë – Shërbimi i parë programor (RTM1) në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi të harmonizojë punën e saj me dispozitat e LShMAAV dhe RrMPM.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita për miratim llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia në bazë të nenit 28 të LShMAAV-së është kompetente për të kryer mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë si dhe të paketave programore të ritransmetuara nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të dispozitave nga Ligji në fjalë, lejet, çertifikatat e dhëna për regjistrim, aktet nënligjore dhe akte të tjera të miratuara nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LShMAAV-së, Këshilli i Agjencisë kundër botuesi të medias (transmetuesi) ndërmerr masë – paralajmërim publik në rastet kur është kryer cënim ose shkelje e dispozitave të LShMAAV-së dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të Ligjit të njëjtë si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në leje dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 50, paragrafi (1) të LShMAAV-së, transmetuesit nuk duhet të transmetojnë ose të bartin programe të cilat mund të dëmtojnë seriozisht zhvillimin fizik, mendor ose moral të të miturve, në veçanti programe të cilat kanë në përmbajtje pornografi ose dhunë të tepruar. Ofruesit e shërbimeve me kërkesë, duhet të ndërmarrin masa teknike më të rrepta për të siguruar që të miturit të jenë të mbrojtur nga përmbajtje të dëmshme siç janë dhuna e tepruar dhe pornografi. Përveç programeve nga paragrafi (1) i këtij neni, programe të tjera që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor dhe moral të të miturve, sigurohen nga ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale në mënyrë që të miturit të mos mund t'i shohin ose dëgjojnë programet.

Nëse programet transmetohen ose ritransmetohen në formë të pakoduar, ofruesi i shërbimit mediatik audioviziv është i detyruar para transmetimit të tyre të ofrojë paralajmërim paraprak akustik dhe mundësinë e njohjes me ndihmën e shenjave vizuale gjatë gjithë kohës së transmetimit të programeve (neni 50, paragrafi 3 të LShMAAV-së).

Në nenin 16 të RrMPM (periudha kohore për kategorinë e programeve) është përcaktuar që, varësisht nga përbërja e pritur e publikut, kategoritë e programeve mund të transmetohen në periudhat kohore në vijim: programet e kategorisë së parë dhe të dytë, transmetohen gjatë gjithë ditë-natës; kategoria e tretë transmetohet në periudhën nga ora 20:00 deri në orën 05:00; kategoria e katërt transmetohet në periudhën nga ora 22:00 deri në orën 05:00; kategoria e pestë transmetohet në periudhën nga ora 00:00 deri në orën 05:00.

Në nenin 17 të RrMPM (përshkrimet e kategorive të programeve), paragrafi (1), pikat 3 dhe 4 parasheh se kategoritë e programeve audiovizuale të përcaktuara në nenin 15 të Rregullores, përcaktohen sipas përshkrimit të mëposhtme: (3) Kategoria e tretë – program që nuk rekomandohet për fëmijë nën 12 vjeç, për shikimin e të cilit është i domosdoshëm mbikëqyrja nga prindi ose kujdestari. Programe skenari i të cilave përfshin përshkrime sistematike dhe të shpeshta, skena dhe/ose pamje të dhunës psiko/fizike, të cilat mund të shqetësojnë të miturit. Përpunimi i temave serioze është i pranueshëm por duhet të jetë i përshtatshëm për moshën e publikut. Gjuha e pahijshme, vulgare dhe brutale lejohet, megjithatë duhet të reduktohet në masë të arsyeshme dhe justifikohet nga funksioni i nevojshëm në kontekstin dramatik ose informativ-dokumentar të programit. Përshkrimet, skenat dhe/ose pamjet e dhunës dhe erotizëm, dhe marrëdhënia e mundshme e ndërsjellë midis këtyre dy faktorëve në zhvillimin e rrëfimit, nuk duhet të theksojnë lëndimet fizike dhe/ose lëndimet psiko-fizike, të të miturve dhe as të përqendrohen në detaje fizike të pahijshme. Nuk duhet t'i jepet rëndësi e tepruar armëve dhe teknikave për përballje ndërpersonale, që janë të lehta për t'u imituar, me potencialin për të ndikuar në mënyrë sugjестive në pjesët psikologjike më pak të qëndrueshme dhe emocionalisht të cenueshme të publikut. Megjithatë, përshkrimi i varësisë nga droga lejohet, pa elaboruar në detaje fazat e aktit të karakterizimit të personazheve dhe duke plotësuar të gjitha llojet përkatëse të programeve artistike, edukative, informative dhe/ose dokumentare. Njoftime për programe të tilla nuk duhet të përbëhen nga përshkrime, skena dhe/ose pamje që mund të shqetësojnë të miturit dhe (4) Kategoria e katërt – programe që nuk rekomandohet për fëmijë nën 16 vjeç, për shikimin e të cilave është i domosdoshëm mbikëqyrja nga prindi ose kujdestari. Programe skenari i të cilave përfshin përshkrime sistematike dhe të shpeshta, skena dhe/ose pamje të dhunës psiko-fizike, të cilat mund të shqetësojnë të miturit. Nuk ka kufizime për temat. Lejohet përdorimi i shpeshtë i gjuhës së pahijshme, megjithatë përdorimi i tepërt i shprehjeve jashtëzakonisht vulgare është vështirë i pranueshëm. Përshkrimi erotizmit dhe marrëdhënies seksuale lejohet, por pa detaje eksplicite pornografike. Është i nevojshëm një kontekst i menduar me kujdes për shprehjet verbale dhe gjestuale që kanë një aludim të fortë seksual dhe mund të ofendojnë dinjitetin njerëzor. Përshkrimi i varësisë nga droga lejohet vetëm pa një shpjegim të detajuar të fazave të aktit të (abuzimit) përdorimit të drogës, të balancuar me treguesin e pasojave dhe në funksion të karakterizimit të personazheve plotësues të të gjitha llojeve të ndryshme të programeve artistike, dramatike, edukative, informative dhe/ose dokumentare. Përshkrimet, skenat dhe/ose skenat e dhunës dhe pasojat e dhunës janë të pranueshme, por jo përshkrimet e sadizmit ose çdo shprehje tjetër e çnjerëzimit dhe të mizorisë ndaj njerëzve dhe kafshëve. Njoftimet për programe të tilla nuk duhet të përmbajnë përshkrime, skena dhe/ose pamje që mund të shqetësojnë të miturit.

Në kuadër të kompetencave të saj ligjore, Agjencia nëpërmjet Sektorit për çështje programore, më 19 gusht 2026, ka kryer mbikëqyrje të jashtëzakonshme programore (monitorim) sipas një ankese (iniciative të një personi fizik) në shërbimin programor televiziv të NPR RADIOTELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonisë – Shërbimi i parë programor (RTM1), transmetuar më 14 gusht 2026, në nivel shtetëror, me ç'rast konstatoi shkelje të nenit 50, paragrafi (3) të LShMAAV-së dhe nenet 16 dhe 17 të RrMPM, të mënyrës që në kundërshtim me nenet 16 dhe 17, dhe sipas kriterëve për kategorizimin e programeve të përcaktuara në LShMAAV-së, filmi „Razuzdaniot dedo (Dirty grandpa)“ është shënuar gabimisht si program i Kategorisë së tretë, e cila nuk rekomandohet për fëmijë nën 12 vjeç dhe u transmetuar në termin të papërshtatshëm të programit (pas orës 20). Sipas këtyre arsyeve, filmi duhej të ishte shënuar si program i – 'Kategorisë së katërt' – që nuk rekomandohet për fëmijë nën 16 vjeç, për shikimin e të cilit është i domosdoshëm mbikëqyrja nga prindi ose kujdestari, përkatësisht duhej të transmetohej në periudhën nga ora 22:00 deri në orën 05:00. Konkretisht, tërësia audiovizuale e filmit artistik „Razuzdaniot dedo (Dirty grandpa)“, i cili sipas produksionit origjinal për sa i përket zhanrit përkufizohet si 'komedi erotike për të rritur', përbëhet kryesisht nga skena dhe/ose skena me lakuriqësi të erotizuar dhe ngacmim/koitus seksual/gjest epshor të stimuluar, si dhe nga përshkrime të konsumimit të drogës dhe alkoolit, me dialogë dhe replika që përmbajnë shprehje të qarta vulgare, shpesh fyese si në bazë racore dhe në bazë gjinore.

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi është specifikura në Raportin me shkrim mbi zbatimin e mbikëqyrjes së programit nr.ark.10-3152/1 të datës 19.08.2026, i cili është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojca nr.1.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (3) të LShMAAV-së, Këshilli i Agjencisë drejtua NPR RADIOTELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonisë – shërbimi i parë programor (RTM1), më 24.08.2026, dërgoi Shkresë nr.y në ark.10-3152/2 të datës 24.08.2026, me të cilin i dërgoi Raportin me shkrim mbi zbatimin e mbikëqyrjes së programit nr.ark.10-3152/1 të datës 19.08.2026, me qëllim që në afat

prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimi të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të paraqesë deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LShMAAV-së dhe RrMPM. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga transmetuesi me datë 24.08.2026. NPR RADIOTELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonisë – Shërbimi i parë programor (RTM1) drejtuar Agjencisë, dorëzoi Deklarim me shkrim nr.03-4887/1 të datës 01.09.2026 (nr.ynë ark.10-3152/3 datë 02.09.2026). Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur me datë 15.09.2026, shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe deklarin me shkrim të paraqitur nga transmetuesi dhe konkludoi që NPR RADIOTELEVISIONI I MAQEDONISË Shup – Televizioni i Maqedonisë – Shërbimi i parë programor (RTM1) t'i shqiptohet masë – paralajmërim publik.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe nenit 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LShMAAV-së, dhe në lidhje me nenin 50, paragrafi (3) nga Ligji i njëjtë dhe nenet 16 dhe 17 të RrMPM, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvnedimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar), Raportin me shkrim mbi zbatimin e mbikëqyrjes së programit nr.ark.10-3152/1 të datës 19.08.2026 dhe Konkluzionin nr.ark.02-3374/3 të datës 15.09.2026, për konstatimin e mos respektimit të dispozitave të LShMAAV-së dhe RrMPM, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën 31. të mbajtur me datë 15.09.2026, miratoi Aktvendim me të cilën publikisht paralajmëron NPR RADIOTELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonisë – Shërbimi i parë programor (RTM1), dhe urdhëron që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimi të Aktvendimit të harmonizojë punën e saj me dispozitat e LShMAAV-së dhe RrMPM. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, me qëllim për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi ka vepruar sipas Aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LShMAAV-së, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë të ngrejë padi, për iniciimin e kontestit administrativ pranë gjykatës kompetente. Padia për iniciimin e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

Bazuar nga sa më sipër, u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- 1) Raport me shkrim mbi zbatimin e mbikëqyrjes së programit nr.ark.10-3152/1 të datës 19.08.2026.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë të ngrejë padi për iniciimin e kontestit administrativ pranë gjykatës kompetente. Padia për iniciimin e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

Përktheu: Antoneta Shabani